



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**  
**DEGA VENDORE TIRANË**

**NOTER MIMOZA R. SHEHU**  
**ADRESA Rr. "Abdyl Frashëri", Pll.3/3**  
**TEL: 0692091283**



# **KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME**

(AKSIONE)

**Nr. repertori: 8693**

**Nr. koleksioni: 3571**

**Tirane më 23/11/2021**

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

\*Akti noterial përbëhet nga 3 fletë



A2021052820406128728





## KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI

( TË SHOQËRISË “HABITAT HOTEL ALBANIA” SH.P.K)

Sot, para meje Notere MIMOZA R. SHEHU, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, Rr."Abdyl Frashëri", Pll.3/3, u paraqit personalisht:

### SHITES:

**Fabian Ndone**, atësia Kozma, amësia Liri, shtetas Shqiptar, lindur në Seman, Fier dhe banues në Tiranë, me adresë Mujo Ulqinaku; Nd. 27/1; H. 1; Ap. 3; Njësia Administrative Nr. 10; Njesia Bashkiake Nr. 10; 1001; Tiranë, lindur më 03/02/1977, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me ID nr. 030581915 dhe nr. personal H70203032D, përfaqësuar me prokurë të tipit "Prokure e posaçme" me Nr. Rep 6249, Nr. kol 3505, hartuar nga notere Fatmir Koseni, në datë 20/11/2021, nga përfaqësuese Lejla Dino, atësia Zeqir, shtetase shqiptare, lindur në Tiranë dhe banuese në Tiranë, lindur më 19/12/1967, madhore me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, për identitetin e së cilës u garantova nga karta e identitetit me nr. personal G76219066J.

### BLERES:

Rubin Lica, atësia Qamil, amësia Marije, shtetas Shqiptar, lindur në Divjakë, Lushnjë dhe banues në Kavajë, me adresë Lagje 1, Rruga 'egnatia'; Nd. Nd.111; Kavajë; Kavajë; 2501; Kavajë, lindur më 07/06/1980, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033344420 dhe nr. personal I00607146G, .

### BAZA LIGJORE

- 3.1 Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 705 dhe vijues të tij;
- 3.2 Ligji 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”;
- 3.3 Ligji nr. 110, datë 20.12.2018 “Për Noterinë”.

### MEQENESE:

- A. Shitësi zotëron 50% te Kapitalit te Shoqërisë “HABITAT HOTEL ALBANIA” Sh.p.k, një shoqëri e themeluar e qe funksionon sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, e regjistruar ne Regjistrin Tregtar Shqiptar me NIPT L82313026V, me seli ne adresën: TIRANE Njesia Bashkiake nr.7, Rruga e Kavajes, ish Parku, Zona kadastrale nr.8220, Numri i pasurise 6/284; (me poshtë referuar “*Shoqëria*”);
- B. Shitësi dëshiron t'i shesë Blerësit dhe Blerësi dëshiron te blejë nga Shitësi 50% te Kapitalit te Shoqërisë së lartpërmendur;
- C. Në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe Ligjin Nr. 9901/2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, si dhe me vendimin bashkëlidhur e ortakeve te Shoqërisë, Palët dëshirojnë te lidhin këtë Kontrate.

**PER SA ME SIPER**, palët bien dakord si vijon:





1. Me nënshkrimin e kesaj Kontrate Shitesi i shtet Blerësit dhe Blerësi blen nga Shitesi te gjithë pjesëmarrjen e ai zoteron ne kapitalin e shoqerise, konkretisht 50% te kapitalit te Shoqerise « HABITAT HOTEL ALBANIA » Sh.P.K.
2. Shitësi deklaron dhe garanton se ka marrë nga Blerësi me para ne dore dhe në mënyrë të plotë të gjithë çmimin e blerjes të rënë dakord prej 50.000 LEKE (pesëdhjete mije leke) perpara lidhjes se kontratës dhe transferon ne pronësinë e Blerësit pjesën prej 50% te kapitalit te Shoqërisë.
3. Shitësi deklaron dhe garanton Blerësin se pjesët e kapitalit te transferuara ketu, janë ne pronesine e tij te plote e ligjore dhe te lira nga barra hipoteke apo pengje.
4. Blerësi blen 50% (pesëdhjetë përqind) te kapitalit te Shoqërisë dhe me nënshkrimin e kësaj Kontrate struktura e zotërimit te kapitalit te Shoqërisë ndryshon si me poshtë:
  - **Z. Rubin Lica, mbetet ortak i vetem, zotërues i 1 kuote te kapitalit qe përfaqëson 100% te kapitalit te Shoqërisë;**
5. Blerësi pranon pronësinë e Kuotës duke njohur gjendjen e Shoqërisë dhe bie dakord me të gjitha të drejtat dhe detyrimet e lindura nga zotërimi i kuotës brenda Shoqërisë, sipas përcaktimeve të Statutit të Shoqërisë dhe ligjit shqiptar.
6. Shitësi dhe Blerësi bien dakord të zbatojnë dhe të paraqesin që në kërkesën e parë të palës tjetër dhe/ose të Shoqërisë të gjitha dokumentet e nevojshme në mënyrë që të kryejnë të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e transferimit te Kuotës objekt të kësaj Marrëveshjeje, pranë Qendrës Kombëtare e Biznesit si dhe në çdo autoritet tjetër Shqiptar sipas përcaktimeve të Ligjit Shqiptar.

#### DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

13.1 Kontrata e Shitjes të kuotave të kapitalit u lexua nga unë Noterja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të Palëve kontraktuese; të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse shprehin vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noteres.

13.2 Unë Noterja, verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62 të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 “Për Noterinë”, vërtetoj nënshkrimin e tyre.


13.3 Në zbatim të Ligjit 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave Personale”, unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpujoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

#### PALËT KONTRAKTUESE

##### SHITES

Fabian Ndone

perfaqesuar nga: Zj.Lejla Dino



Notere  
MIMOZA R. SHEHU

##### BLERES

Rubin Lica